

me emër dhe mbiemër, e kanë humbur jetën apo janë zhdukur me dhunë gjatë luftës në vitin 1998. Ne nuk nxjerrim përfundime juridike, por jemi të sigurt se faktet që i bëjmë publike janë relevante për procedimin e krimeve të luftës, si dhe rishqyrtimin vetëkritik të ngjarjeve, si dhe veprimeve të institucioneve, palëve në konflikt dhe individëve.

Leximi dhe kërkimi i regjistrimeve

Regjistrimet për njerëzit që e kanë humbur jetën apo janë zhdukur në mënyrë të dhunshme i kemi sistemuar sipas radhitjes së komunave në bazë të alfabetit. Në kuadrin e komunave, regjistrimet radhiten sipas datës dhe vendit të vrasjes, pësimit apo zhdukjes së njerëzve gjatë luftës, apo lidhur me shkaqet e luftës. Regjistrimi fillon me të dhëna themelore personale, kalon në shënim për jetën dhe vdekjen e një apo më shumë personave, dhe përfundon me dhënie të burimeve që e dokumentojnë narracionin.

Të dhënat themelore përmbajnë emrin e personit të vrarë, apo atij që ka pësuar ose është zhdukur, mbiemrin e vajzërisë së gruas, mbiemrin e të vrarit/të pësuarit/të zhdukurit, datën e lindjes, përkatësinë etnike, vendbanimin e fundit të njohur, profesionin apo veprimtarinë, numrin e fëmijëve, gjendjen martesore, dhe në rastin e ushtarëve dhe policëve statusin e tyre në kuadrin e formacionit të armatosur. Në rastin kur më shumë persona e kanë humbur jetën apo janë zhdukur në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë, regjistrimi fillon me të dhënat themelore për personin më të moshuar dhe përfundon me të dhënat për personin më të ri. Por, këtë rregull nuk e kemi respektuar në rastin e ngjarjeve masive, kur ne mesin e të vrarëve, të pësuarve dhe të zhdukurve, përveç tjerëve ka edhe më shumë anëtarë të një familjeje të vetme. Në këto raste, jemi përkujdesur që anëtarët e një familjeje t'i mbajmë në një vend, duke filluar nga të dhënat themelore e deri te tregimi për jetën dhe pësimin e tyre, para se gjithash, për të respektuar nevojën e familjeve që viktimat e tyre t'i mbajnë së bashku.

Në kuadrin e narracionit kemi bërë përpjekje që më së miri që ishte e mundur t'i përshkruajmë njerëzit, jetën e tyre dhe rrethanat e vdekjes së tyre apo të zhdukjes së dhunshme. Është e dukshme se narrativi është i qartë dhe me emocione të thella kur flasim për viktimat e krimeve të luftës. Po ashtu, është e qartë se kemi tepër pak të dhëna për rrethanat e pësimit të pjesëtarëve të UJ-së, MPB-së dhe UÇK-së. Pjesët përbërëse të narrativit janë edhe të dhëna për lokalitetet e varrimit, të njohura dhe të zbuluara më vonë, zhvarrimet, identifikimet dhe rivarrimet, sepse kemi krijuar bindje se bëhet fjalë për të dhëna shumë të rëndësishme për familjet.

Në kuadrin e burimeve i kemi numëruar dokumentet në bazë të të cilëve e kemi dokumentuar pësimin apo zhdukjen e dhunshme të një personi të caktuar [më shumë personave] dhe e kemi regjistruar shënimin për të [ta]. Në burimet përmenden shkurtesat e dokumenteve të përdorura, ndërkaq në fund të librit, në kuadrin e anekseve, japim tituj të plotë të burimeve.

Metoda e hulumtimit dhe e analizës

Për vrasjet, rrëmbimet, arrestimet e paligjshme, zhdukjet e dhunshme dhe abuzimet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut të shqiptarëve mësonim nga mediat shqiptare, Këshilli për